Raport krahasimor për vlerësimin institucional me nxënësit, mësuesit, prindërit dhe bizneset

Shkolla Profesionale Elbasan (SHPE)

Viti shkollor 2025 - 2026

Shtator 2026

Tabela e përmbajtjes

Lista e Tabelave 3

Hyrje 5

Metodologjia 5

Të dhëna për pjesëmarrësit 2026 7

Rezultatet 8

- Zhvillimi i vazhduar profesional 8
- Kurrikula 9
- Marrëdhënia me biznesit 9
- Orientimi në karrierë 10
- Projektet 11
- Marketingu 12
- Gjurmimi në nivel ofruesi 13

Lista e Tabelave

Tabela 1: Numri i pyetësorëve të plotësuar për secilin target grup 7
Tabela 2: Rezultatet për treguesit e zhvillimit të vazhduar profesional 8
Tabela 3: Rezultatet për treguesit e kurrikulës 9
Tabela 4: Rezultatet për treguesit e marrëdhënieve me biznesin 10
Tabela 5: Rezultatet për treguesit e orientimit në karrierë 11
Tabela 6: Rezultatet për treguesit e projekteve 11
Tabela 7: Rezultatet për treguesit e marketingut 12
Tabela 8: Rezultatet për treguesit e gjurmimit në nivel ofruesi 13

© 2026 Swisscontact

Rreth projektit "Aftësi për Punë" (S4J)

Aftësi për Punë (S4J) është një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) i zbatuar nga Swisscontact, i cili synon të adresojë sfidat kryesore në Arsimin dhe Formimin Profesional (AFP) në Shqipëri. Që prej tetorit 2015, projekti "Aftësi për Punë" (S4J) mbështet qeverinë dhe aktorët e tjerë të interesit për të ndërtuar një sistem cilësor të AFP në Shqipëri, i frymëzuar nga modeli zviceran. Në fazën e tij të tretë (2024-2027), me theks të veçantë tek qëndrueshmëria, projekti është angazhuar në ndarjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të njohurive dhe përvojave të përftuara në nivel sistemi, në bashkëpunim të ngushtë me shkollat partnere.

Hyrje

Ky raport paraqet gjetjet nga procesi i **Vlerësimit Institucional** të zhvilluar në **Shkollën Profesionale Elbasan** për vitin shkollor 2025 - 2026. Procesi, me synim vlerësimin e cilësisë së shërbimeve të aftësimit profesional, përfshiu nxënës, mësues, prindër dhe biznese partnere, të cilët u anketuan gjatë periudhës maj-qershor 2026. Ky vit shënon realizimin e procesit për të tretin vit radhazi, duke e konsoliduar si një praktikë të qëndrueshme dhe të rëndësishme për përmirësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve.

Procesi u koordinua nga Njësia e Zhvillimit (NjZh) në shkollë, e cila luan një rol kyç në monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimeve. Përshkrimi i gjetjeve në raport është i organizuar sipas treguesve për secilin funksion të NJZH-së.

Ky proces vlerësues mbështetet në përvojën e vitit shkollor 2023 - 2024, ku projekti 'Aftësi për Punë' (S4J), në bashkëpunim me gjashtë shkolla partnere[1], zhvilloi katër instrumente vlerësimi (pyetësorë), të bazuar në një metodologji rigoroze dhe pjesëmarrëse. Pas pilotimit në gjashtë shkolla, instrumentet u rishikuan për të garantuar vlefshmëri, qëndrueshmëri dhe respektim të standardeve etike[2].

Metodologjia

Në kuadër të mbledhjes së informacionit që do të ushqejë analizën vjetore të performancës institucionale, në përfundim të çdo viti shkollor do të realizohet një proces vlerësimi institucional në nivel ofruesi duke përfshirë katër grupeve kryesore: nxënës, mësues, biznese dhe prindër. Ky proces synon të vlerësojë performancën institucionale, të identifikojë fushat për përmirësim dhe të informojë objektivat e planit vjetor të institucionit.

Për këtë qëllim, janë zhvilluar katër instrumente vlerësimi (pyetësor), si vijon:

Pyetësori për nxënësit synon të mbledh mendimet dhe përvojat e nxënësve për cilësinë e shërbimeve të aftësimit profesional. Fokusohet në cilësinë e mësimdhënies, praktikën profesionale, orientimin në karrierë dhe performancën e institucionit. Qëllimi është përmirësimi i programeve për të përgatitur më mirë nxënësit për tregun e punës.

Pyetësori për mësuesit synon të mbledh mendimet dhe përvojat e mësuesve për cilësinë e shërbimeve të aftësimit profesional dhe mjedisit të të nxënit. Fokusohet në zhvillimin profesional, zbërthimin e kurrikulës, projektet zhvillimore dhe dhe performancën e institucionit. Qëllimi është identifikimi i fushave për përmirësim dhe përshtatja e praktikave me nevojat e stafit dhe nxënësve.

---

[1] Hamdi Bushati, Kolin Gjoka, Kristo Isak, Shkolla Profesionale Elbasan, Shkolla Teknike Ekonomike Tirane, Tregtare.
[2] Për më shumë informacion, shih raportin Baseline i treguesve të cilësisë së Njësisë së Zhvillimit https://skillsforjobs.al/publications/baseline-i-treguesve-te-cilesise-se-njesise-se-zhvillimit/

Pyetësori për bizneset synon të mbledh perceptimet e bizneseve për cilësinë e bashkëpunimit me institucionin dhe përvojën me nxënësit gjatë praktikës profesionale. Fokusohet në përgatitjen e nxënësve, përputhshmërinë e programeve të praktikës me nevojat e tregut të punës dhe mundësitë për përmirësim. Qëllimi është forcimi i bashkëpunimit dhe angazhimi cilësor i sektorit privat në proceset e aftësimit profesional.

Pyetësori për prindërit synon të mbledhë mendimet e prindërve për cilësinë e shërbimeve të aftësimit profesional. Fokusohet në komunikimin me shkollën, orientimin në karrierë të fëmijëve dhe imazhin e institucionit. Qëllimi është përmirësimi i shërbimeve për të përmbushur pritshmëritë dhe nevojat e nxënësve dhe prindërve.

Të dhëna për pjesëmarrësit 2026

Për vitin shkollor 2025-2026, në Shkollën Profesionale Elbasan (SHPE) 887 nxënës morën pjesë në sondazh. Nga këta, 86.1% (N=764) ishin djem, 13% (N=115) ishin vajza dhe 0.9% (N=8) kanë preferuar të mos përgjigjen. Të shpërndarë sipas klasave, 29% (N=253) e të anketuarve janë në klasën e dhjetë, 24.4% (N=213) në klasën e njëmbëdhjetë, 24.1% (N=210) në klasën e dymbëdhjetë, 21.8% (N=190) në klasën e trembëdhjetë dhe 0.8% (N=7) arsim profesional pas të mesëm. Të pyetur mbi mtodat e mësimdhënies që mësuesit përdorin në klasë (si p.sh., puna në grup, puna me projekte, përdorimi i teknologjisë etj) 40.6% (N=360) kanë pohuar që janë të kënaqur. 49.1% (N=299) e nxënësve pohojnë se ajo që kërkohet në biznes është shumë e ngjashme me njohuritë që merr në institucion.

Ndërkohë, morën pjesë në anketim 29 mësues, nga ku 65.5% (N=19) janë femra dhe 34.5% (N=10) janë meshkuj. Të ndarë sipas lëndëve që japin mësim 37.9% (N=11) japin lëndë të teorisë profesionale, 37.9% (N=11) japin njëkohësisht lëndë të teorisë profesionale dhe module të praktikës profesionale dhe 24.1% (N=7) japin module të praktikës profesionale. Te pyetur sa të kënaqur janë me mbështetjen që ju është dhënë nga koordinatori i ZHVP-së gjatë zbatimit të aktiviteteve të planit të zhvillimit profesional, 50.0% (N=14) pohojnë se janë të kënaqur. 51.7% (N=15) e mësuesve të anketuar pohojnë se e kanë jashtëzakonisht të lehtë përgatitjen e planifikimit ditor. Të pyetur nëse kanë djeni rreth projekteve në institucion, 50% (N=14) pohojnë se kanë djeni por vetëm 10.3% (N=3) e të anketuarve kanë qënë pjesë e një grupi pune për projekte zhvillimore gjatë këtij viti.

Në sondazhin për bizneset partnere të shkollës kanë marrë pjesë 94 biznese, nga ku 93.4% (N=85) pohojnë se kanë pritur nxënës nga shkolla për zhvillimin e praktikës profesionale gjatë këtij viti shkollor. 74.1% (N=60) e bizneseve shprehen se janë të kënaqur për bashkëpunimin me shkollën por vetëm 46.2% (N=43) shprehen se e njohin shumë mirë programin/ofertën mësimore të institucionit (drejtime/profile), por shprehen se janë të kënaqur me gatishmërinë dhe përgatitjen e nxënësve gjatë zhvillimit të praktikës profesionale në bizneset e tyre 53.8% (N=49).

Për vitin shkollor 2025-2026 në Shkollën Profesionale Elbasan (SHPE) janë anketuar 515 prindër. Nga këta 41% (N=211) ishin meshkuj, 57.7% (N=297) ishin femra dhe 1.4% (N=7) kanë preferuar të mos përgjigjen. Të shpërndarë sipas klasën që ndjek fëmija, 28.8% (N=147) kanë pohuar se fëmija e tyre ndjek klasën e dhjetë, 24.3% (N=124) klasën e njëmbëdhjetë, 24.9% (N=127) në klasën e dymbëdhjetë, 21.0% (N=107) në klasën e trembëdhjetë dhe 1.0% (N=5) arsim profesional pas të mesmes. 48.5% (N=249) e prindërve të anketuar janë shprehur se janë të kënaqur me cilësinë e komunikimit me shkollën, dhe 68.4% (N=336) shumë të kënaqur me shërbimin për orientimin në karrierë.

Tabela 1: Numri i pyetësorëve të plotësuar për secilin target grup

Përfituesit	2024	2025	2026
Nxënës	681	532	887
Mësues	48	52	29
Prindër	411	281	515
Biznese	134	122	94

Rezultatet

Seksionet më poshtë përmbledhin rezultatet e matjeve me nxënësit, mësuesit, prindërit dhe bizneset.

Zhvillimi i vazhduar profesional

Rezultatet për zhvillimin e vazhduar profesional tregojnë një ecuri të përzier gjatë viteve 2024–2026. Përputhja e aktiviteteve të ZHVP-së me nevojat e mësuesve u rrit nga 52.1% në 2024 në 80.8% në 2025, por ra në 75.9% në 2026. Po ashtu, përmirësimi i aftësive nga trajnimet dhe kënaqësia me mbështetjen arritën nivelet më të larta në 2025, përkatësisht 94.2% dhe 88.5%, duke rënë në 65.5% dhe 71.4% në 2026. Në të kundërt, zbatimi në mësimdhënie i njohurive dhe metodave të fituara nga trajnimet ka shënuar rritje të vazhdueshme, nga 60.5% në 2024 në 80.8% në 2026. Te nxënësit, kënaqësia me metodat e mësimdhënies ka mbetur relativisht e qëndrueshme rreth 69% në 2025–2026, ndërsa kënaqësia me metodat e përdorura gjatë procesit mësimor është rritur nga 44.0% në 2025 në 60.4% në 2026.

Tabela 2: Rezultatet për treguesit e zhvillimit të vazhduar profesional

Përfitues të shërbimit	Treguesit e cilësisë	Rezultati 2024 %	Rezultati 2025 %	Rezultati 2026 %
Mësuesit e kulturës profesionale – përfitues direkt	1. Aktivitetet e ZHVP janë në përputhje me nevojat e mësuesve.	52.1	80.8	75.9
	2. Aftësitë e mësuesve janë përmirësuar nga trajnimet/aktivitetet e parashikuara në planin e ZHVP.	77.1	94.2	65.5
	3. Mësuesit janë të kënaqur me mbështetjen që kanë marrë gjatë zbatimit të planit të ZHVP.	77.1	88.5	71.4
	4. Mësuesit aplikojnë në mësimdhënie njohuritë aftësitë, shprehitë dhe metodat e reja të mësimdhënies që kanë mësuar në trajnime dhe shkëmbime.	60.5	78.8	80.8
Nxënësit – përfitues indirekt	1. Nxënësit janë të kënaqur me metodat e mësimdhënies (si p.sh., puna në grup, puna me projekte, përdorimi i teknologjisë, ndërveprimi në klasë etj.).	74.3	69.0	69.2
	2. Nxënësit janë të kënaqur me metodat e përdorura gjatë procesit të mësimdhënies.		44.0	60.4
	3. Nxënësit janë të kënaqur me shpeshtësinë e ndërveprimit gjatë procesit mësimor.	62.0	59.7	63.1

Kurrikula

Rezultatet për treguesit e kurrikulës tregojnë një ecuri përgjithësisht pozitive, por me disa luhatje ndërmjet viteve. Lehtësia e mësuesve në zbërthimin e kurrikulës në përputhje me nevojat e tregut të punës është rritur nga 64.6% në 2024, në 67.3% në 2025 dhe në 93.1% në 2026. Në të kundërt, kënaqësia e mësuesve me mbështetjen e koordinatorit të kurrikulës u rrit nga 85.4% në 92.3% në 2025, por ra në 72.4% në 2026. Te nxënësit, perceptimi për përshtatjen e programit mësimor me tregun e punës ra nga 86.7% në 2024 në 78.8% në 2025, duke u përmirësuar në 81.7% në 2026. Ndërsa te bizneset, kënaqësia me njohuritë dhe aftësitë e nxënësve është rritur vazhdimisht nga 79.7% në 87.9%, ndërsa përshtatja e planeve të praktikës me nevojat e tyre u rrit në 2025, por ra në 71.7% në 2026.

Tabela 3: Rezultatet për treguesit e kurrikulës

Përfitues të shërbimit	Treguesit e cilësisë	Rezultati 2024 %	Rezultati 2025 %	Rezultati 2026 %
Mësuesit – përfitues direkt	1. Mësuesit e kanë më të lehtë zbërthimin e kurrikulës në përputhet me nevojat rajonale të tregut të punës.	64.6	67.3	93.1
	2. Mësuesit janë të kënaqur me mbështetjen që kanë marrë nga koordinatori i kurrikulës për zbatimin e mësimdhënies	85.4	92.3	72.4
Nxënësit – përfitues indirekt	1. Nxënësit mendojnë se programi mësimor është e përshtatur me tregun e punës.	86.7	78.8	81.7
Bizneset – përfitues indirekt	1. Bizneset janë të kënaqur me njohuritë, aftësitë dhe shprehitë që kanë marrë nxënësit në shkollë.	79.7	86.7	87.9
	2. Bizneset mendojnë se planet e praktikës profesionale janë në përshtatje me nevojat e tyre.	70.7	76.0	71.7

Marrëdhënia me biznesit

Të dhënat e tre viteve tregojnë se marrëdhënia me biznesin është forcuar në disa drejtime, por jo në mënyrë të njëtrajtshme. Rritja më e dukshme lidhet me pjesëmarrjen e nxënësve në praktikë profesionale, e cila ka kaluar nga 59.2% në vitin 2024 në 85.3% në 2026. Ndërkohë, kënaqësia e nxënësve me mundësitë dhe organizimin e praktikës ka pësuar rënie në vitin 2026. Nga perspektiva e bizneseve, bashkëpunimi në forma të ndryshme me shkollën dhe vlerësimi për përgatitjen e nxënësve mbeten në nivele të larta, ndërsa bashkëpunimi i ngushtë ka shënuar një rënie të fortë krahasuar me vitin 2025. Pozitive është edhe rritja e njohjes së programit mësimor dhe moduleve profesionale të shkollës në vitin 2026.

Tabela 4: Rezultatet për treguesit e marrëdhënieve me biznesin

Përfitues të shërbimit	Treguesit e cilësisë	Rezultati 2024 %	Rezultati 2025 %	Rezultati 2026 %
Nxënësit – përfitues direkt	1. % e nxënësve që kanë bërë praktikë profesionale në biznes.	59.2	72.4	85.3
	2. Niveli i kënaqësisë së nxënësve me mundësitë që ofron shkolla për praktikë profesionale në biznes.	83.0	83.4	71.4
	3. Niveli i kënaqësisë së nxënësve me realizimin e praktikës profesionale në biznes sipas planit të praktikës.	83.2	83.4	72.4
Bizneset – përfitues direkt	1. Bizneset bashkëpunojnë në forma të ndryshme me shkollën.	85.8	94.1	94.7
	2. Bizneset janë të kënaqura për bashkëpunimin me shkollën.	77.9	70.8	74.1
	3. Bizneset bashkëpunojnë ngushtë me shkollën.	30.8	82.5	31.9
	4. Bizneset janë të kënaqur me cilësinë e përgatitjes së nxënësve nga shkolla.	82.8	86.7	87.9
	5. Bizneset mendojnë se shkolla përmbush nevojat e biznesit për aftësi cilësore pune.	76.9	80.5	78.7
	6. Biznesi njeh programin mësimor që ofron shkolla.	58.3	56.3	72.0
	7. Biznesi njeh shumë mirë modulet profesionale qe ofron shkolla.	60.4	68.3	72.8

Orientimi në karrierë

Për orientimin në karrierë, të dhënat tregojnë një përmirësim të vazhdueshëm në aksesin e nxënësve ndaj shërbimeve, nga 82.7% në 2024 në 89.2% në 2025 dhe 91.2% në 2026. Edhe kënaqësia me cilësinë e këtyre shërbimeve është rritur lehtë, duke arritur 76.2% në 2026. Ndryshe paraqitet informimi për mundësitë e punësimit, i cili ra ndjeshëm nga 76.5% në 2024 në 53.1% në 2025, por u rikuperua pjesërisht në 61.3% në 2026. Te prindërit, kënaqësia me shërbimin e orientimit në karrierë u përmirësua lehtë në 2026 pas rënies së vitit 2025, ndërsa perceptimi se orientimi ka ndihmuar fëmijët në vendimmarrje për karrierën mbetet më i ulët se niveli i vitit 2025.

Tabela 5: Rezultatet për treguesit e orientimit në karrierë

Përfitues të shërbimit	Treguesit e cilësisë	Rezultati 2024 %	Rezultati 2025 %	Rezultati 2026 %
Nxënësit – përfitues direkt	1. Nxënësit kanë marrë shërbime të ndryshme për orientimin në karrierë.	82.7	89.2	91.2
	2. Nxënësit janë të kënaqur me cilësinë e shërbimit të ofruar në sesionet e orientimit në karrierë.	74.3	76.5	76.2
	3. Nxënësit janë të informuar për shanset e punësimit pas diplomimit në profilin që po studiojnë.	76.5	53.1	61.3
Prindërit – përfitues indirekt	1. Prindërit janë të kënaqur me shërbimin për orientim në karrierë që i jep shkolla fëmijës.	71.2	66.2	68.4
	2. Prindërit besojnë se orientimi në karrierë e ka ndihmuar fëmijën për të marrë vendimet e duhura për karrierën.	68.0	79.5	71.2

Projektet

Për treguesit e projekteve, tabloja është më e luhatshme. Njohja e projekteve nga mësuesit u rrit nga 54.2% në 2024 në 72.5% në 2025, por ra në 57.1% në 2026; ndërsa perceptimi se projektet përmirësojnë cilësinë e arsimit u përmirësua nga 54.2% në 60.7%. Pozitivisht, përfshirja e mësuesve në hartimin e projekteve është rritur vazhdimisht, nga 14.6% në 2024 në 34.5% në 2026. Te nxënësit, njohja e projekteve u rrit ndjeshëm në 67.5% në 2026, ndërsa përfshirja në projekte, pas rritjes së fortë në 2025, ra në 43.8%. Kënaqësia me aktivitetet e projekteve mbeti në 64.3% në 2026, ndërsa kënaqësia me rezultatet e tyre u përmirësua në 73.1%.

Tabela 6: Rezultatet për treguesit e projekteve

Përfitues të shërbimit	Treguesit e cilësisë	Rezultati 2024 %	Rezultati 2025 %	Rezultati 2026 %
Mësuesit – përfitues direkt	1. Mësuesit i njohin projektet zhvillimore të shkollës	54.2	72.5	57.1
	2. Mësuesit mendojnë se projektet zhvillimore të shkollës përmirësojnë cilësinë e arsimit	54.2	61.5	60.7
	3. Mësuesit janë të përfshirë në shkrimin e projekteve zhvillimore si pjesë e grupeve të punës	14.6	25.0	34.5

	4. Mësuesit janë të përfshirë zbatimin e projekteve zhvillimore.	14.6	28.8	
Nxënësit – përfitues direkt	1. Nxënësit janë të dijeni të projekteve zhvillimore në shkollë.	54.8	54.8	67.5
	2. Nxënësit janë të përfshirë në projekte zhvillimore	9.4%	52.0	43.8
	3. Nxënësit janë të kënaqur me përfshirjen në aktivitete të projekteve të zhvilluara nga shkolla.	74.2%	64.3	64.3
	4. Nxënësit janë të kënaqur me rezultatet e projekteve të zbatuara nga shkolla.	75.3%	69.2	73.1

Shënim:* Treguesit 3 dhe 4 janë llogaritur vetëm për mësuesit që raportuan pjesëmarrje në grupet e punës për projektet zhvillimore (N=10; 34.5% e kampionit total të shkollës).

Marketingu

Për treguesit e marketingut, rezultatet e vitit 2026 paraqesin një tablo me përmirësime të dukshme në disa grupe, por edhe me dobësim të disa elementeve të komunikimit. Te mësuesit, kënaqësia me aktivitetet e marketingut mbetet e lartë në 77.8%, ndërsa përfshirja e tyre në këto aktivitete është rritur ndjeshëm nga 20.8% në 2024 në 53.6% në 2026. Megjithatë, vlerësimi për cilësinë e materialeve informuese ka rënë nga 90.2% në 2025 në 75.0% në 2026, dhe kënaqësia me imazhin e shkollës ka zbritur në 77.8%. Te nxënësit, kënaqësia me aktivitetet e marketingut është rritur gradualisht në 61.3%, por perceptimi për cilësinë e informacionit ka rënë ndjeshëm në 45.3%, ndërsa përfshirja e tyre në aktivitetet e marketingut mbetet e ulët, në 18.2%. Në të kundërt, perceptimi i bizneseve dhe prindërve për imazhin e shkollës është përmirësuar në vitin 2026, duke arritur përkatësisht 84.9% dhe 73.3%.

Tabela 7: Rezultatet për treguesit e marketingut

Përfitues të shërbimit	Treguesit e cilësisë	Rezultati 2024 %	Rezultati 2025 %	Rezultati 2026 %
Mësuesit – përfitues indirekt	1. Mësuesit janë të kënaqur me aktivitetet e planit të marketingut të shkollës.	68.8	78.8	77.8
	2. Mësuesit mendojnë se materialet informuese për marketingun janë cilësore	81.4	90.2	75.0
	3. Mësuesit janë të kënaqur me imazhi që ka shkollë	89.6	96.2	77.8
	4. Mësuesit ndihen të përfshirë në aktivitetet e marketingut të shkollës.	20.8	50.0	53.6
Nxënësit – përfitues indirekt	1. Nxënësit janë të kënaqur me aktivitetet e marketingut të shkollës	56.1	59.5	61.3

	2. Nxënësit mendojnë se informacioni i dhënë në materialet e marketingut është cilësor.	70.7	71.3	45.3
	3. Nxënësit janë të kënaqur me imazhit të shkollës.	63.0	60.7	62.4
	4. Nxënësit ndihen të përfshirë në aktivitetet e marketingut.	19.8	23.2	18.2
Bizneset – përfitues indirekt	1. Bizneset e vlerësojnë shkollën si institucion me reputacion/ imazh të mirë.	78.9	71.1	84.9
Prindërit – përfitues indirekt	1. Prindërit e nxënësve të shkollës dhe nxënësve të klasave të 8-9 vlerësojnë shkollën si institucion me imazh të mirë.	61.3	65.1	73.3

Gjurmimi në nivel ofruesi

Për gjurmimin në nivel ofruesi, rezultatet e vitit 2026 tregojnë një zhvillim të pabarabartë mes dy treguesve. Përdorimi i të dhënave të gjurmimit nga drejtuesit dhe mësuesit për përmirësimin e procesit mësimor u rrit nga 39.6% në 2024 në 65.4% në 2025, por ra ndjeshëm në 37.9% në 2026. Në të kundërt, përdorimi i këtyre të dhënave nga shkolla për përmirësimin e aktivitetit vjetor ka ndjekur një prirje të qëndrueshme në rritje, nga 56.3% në 2024 në 67.3% në 2025 dhe 79.3% në 2026. Kjo sugjeron se përdorimi i të dhënave është forcuar në nivel institucional, ndërsa zbatimi i tyre në procesin e drejtpërdrejtë mësimor mbetet më i paqëndrueshëm.

Tabela 8: Rezultatet për treguesit e gjurmimit në nivel ofruesi

Përfitues të shërbimit	Treguesit e cilësisë	Rezultati 2024 %	Rezultati 2025 %	Rezultati 2026 %
Drejtuesi dhe Mësuesit – përfitues direkt	1. Drejtuesit dhe mësuesit përdorin të dhënat e gjurmimit për të përmirësuar procesin mësimor dhe aktivitetet e lidhura me të.	39.6	65.4	37.9
	2. Shkolla i përdor të dhënat e gjurmimit për përmirësimin e aktivitetit vjetor	56.3	67.3	79.3

Rekomandime për forcimin institucional

Rekomandimet e mëposhtme lidhen drejtpërdrejt me gjetjet e raportit për Shkollën Profesionale Elbasan. Për treguesit e mësuesve, krahasimet duhen interpretuar duke marrë parasysh pjesëmarrjen e 29 personave në 2026, nga 52 në 2025. Për ndryshimet e mëdha ose rezultatet që kërkojnë sqarim, hapi i parë është verifikimi dhe diskutimi me grupet përkatëse.

1. Informacion më cilësor dhe më shumë përfshirje të nxënësve

Materialet informuese të rishikohen me nxënësit dhe mësuesit, që informacioni për profilet, praktikën dhe mundësitë pas diplomimit të jetë i qartë dhe i përditësuar. Nxënësve t'u jepen role konkrete në përgatitjen dhe realizimin e aktiviteteve të marketingut.

Gjetja: Vlerësimi i nxënësve për cilësinë e informacionit ra nga 71.3% në 45.3%, ndërsa përfshirja në aktivitetet e marketingut nga 23.2% në 18.2%. Edhe te mësuesit, vlerësimi i cilësisë së materialeve ra nga 90.2% në 75.0%.

2. Të përmirësohet organizimi i praktikës në biznes

Pas çdo periudhe praktike të mblidhen vlerësimet e nxënësve për detyrat, mbështetjen nga mentorët dhe realizimin e planit. Planet të rishikohen me bizneset pritëse, duke u mbështetur në vështirësitë e identifikuara.

Gjetja: Pjesëmarrja e nxënësve në praktikë në biznes u rrit nga 72.4% në 85.3%, por kënaqësia me mundësitë e praktikës ra nga 83.4% në 71.4% dhe me realizimin sipas planit nga 83.4% në 72.4%. Vlerësimi i bizneseve për përshtatjen e planeve me nevojat e tyre ra nga 76.0% në 71.7%.

3. Të sqarohet nevoja për mbështetje të mësuesve

Njësia e Zhvillimit të organizojë një takim reflektimi për dobinë e aktiviteteve të ZHVP-së dhe mbështetjen gjatë zbatimit të planit dhe të kurrikulës. Nga diskutimi të përcaktohen nevojat konkrete për trajnim, këshillim dhe shkëmbim mes kolegëve.

Gjetja: Vlerësimi se trajnimet përmirësojnë aftësitë e mësuesve ra nga 94.2% në 65.5%. Kënaqësia me mbështetjen për ZHVP-në ra nga 88.5% në 71.4% dhe me mbështetjen e koordinatorit të kurrikulës nga 92.3% në 72.4%. Ndërkohë, lehtësia në zbërthimin e kurrikulës u rrit në 93.1%, ndaj duhet sqaruar se cilat forma mbështetjeje mungojnë.

4. Të kuptohet ndryshimi në bashkëpunimin e ngushtë me bizneset

Të verifikohet treguesi dhe përbërja e bizneseve të anketuara, më pas të diskutohen me partnerët nevojat për komunikim dhe koordinim më të rregullt gjatë praktikës.

Gjetja: Bizneset që raportojnë bashkëpunim të ngushtë me shkollën ranë nga 82.5% në 31.9%, ndërsa 94.7% raportojnë bashkëpunim në forma të ndryshme dhe 87.9% vlerësojnë pozitivisht

përgatitjen e nxënësve. Ndryshimi i madh kërkon verifikim para se të interpretohet si dobësim i marrëdhënieve.

5. Projekte më të dukshme dhe më të hapura për pjesëmarrje

Projektet në zbatim të prezantohen periodikisht para stafit dhe në klasa, duke sqaruar qëllimin, rezultatet dhe mundësitë e pjesëmarrjes. Të diskutohen pengesat që kufizojnë përfshirjen e nxënësve.

Gjetja: Njohja e projekteve nga mësuesit ra nga 72.5% në 57.1%. Megjithëse njohja nga nxënësit u rrit në 67.5%, përfshirja e tyre ra nga 52.0% në 43.8%. Kënaqësia me pjesëmarrjen mbeti në 64.3%.

6. Gjurmimi të përdoret më shumë në mësimdhënie dhe orientim

Gjetjet e gjurmimit të diskutohen me ekipet lëndore dhe të përdoren për përshtatjen e detyrave mësimore, praktikës dhe informacionit për punësimin. Sesionet e orientimit të përfshijnë shembuj konkretë nga rrugët e të diplomuarve dhe kërkesat e punëdhënësve.

Gjetja: Përdorimi i të dhënave të gjurmimit për përmirësimin e procesit mësimor ra nga 65.4% në 37.9%, ndërsa përdorimi për aktivitetin vjetor të shkollës u rrit në 79.3%. Megjithëse 91.2% e nxënësve kanë marrë shërbime orientimi, vetëm 61.3% ndihen të informuar për shanset e punësimit pas diplomimit.

Shtojca

Gjetjet nga pyetësorët, viti shkollor 2025-2026

Shkolla Profesionale Elbasan_Indeksi.xlsx